

Kartë - Teknologjike

“Përdorimi i herbicideve në mbrojtje të kulturës së ullirit”

1. Përdorimi i herbicideve

Flora në ullishte përbën një nga pjesët më të rëndësishme të agrosistemit të saj. Bimët quhen konkurruese, për dëmet që shkaktojnë, por ato paraqesin dhe avantazhe dhe kontribuojnë në ruajtjen e ekuilibrit ambiental.

Menaxhimi i tokës nënkupton menaxhimin e barërave konkurrues.

Prania e tyre në ullishte shkakton dëme të ndryshme:

- konkurrojnë kulturën e ullirit për ujë dhe lëndë ushqyese, veçanërisht kur uji mungon dhe fruti është në zhvillim e sipër.
- kosto e vjeljes në toka me barëra konkurrues është e lartë
- mund të shkaktojnë shtim të rreziqeve nga dëmtues dhe sëmundje të ndryshme

Ndërsa avantazhet e ruajtjes së florës spontane do të ishin:

- mbrojnë tokën, kontribuojnë në gjenezën e saj, reduktojnë fenomenin e erozionit
- favorizojnë praninë e specieve dhe kafshëve duke ruajtur biodiversitetin
- shtojnë lëndën organike në tokë, fiksojnë substanca ushqyese dhe CO₂

Sigurisht strategjia e menaxhimit të vegjetacionit lidhet ngushtë me produktivitetin e prodhimit. Prandaj sot zgjedhja e teknologjisë që duhet përdorur duhet të garantojë efektivitet të lartë ekonomik. Në këtë sens fermeri proferon përdorimin e atij sistemi (punim, livadh apo trajtim me herbicid) që është më pak i kushtushëm, krijon kushtet e duhura për të ushqyerit e bimës, garanton arritjen e qëllimit të mësipërm dhe nuk ndikon në ndotjen e ambientit.

Barërat konkurrues që zhvillohen në ullishte: *Agropyrum repense*, *Agrostis* spp, *Allium* spp, *Alopecurus myosuroides*, *Amathus retroflexus*, *Anagallis arvensis*, *Artemisia vulgaris* etj.

Për luftimin e tyre sot në treg gjenden mbi 250 lloje herbicidesh. Më poshtë do të japim të dhëna për disa nga më të përhapurit, që përdoren në ullishtari, mënyrat e përlllogaritjes së shpërndarjes dhe këshillime të ndryshme lidhur me këtë operacion pune.

Herbicide të aplikuara në gjethe: Paraquat, Diquat, Glyphosate, Aminotriazol, 3 – ATL

Herbicide që veprojnë para mbirjes së barërave konkurrues:

Ureici: Urea, Linuron, Diuron, Chlorbromuron

Triazinici: Simazina, Atrazina, Trietazina,

Derivate të acidit Fenoksiacetik: 2,4 – D, Mecoprop, MCPA, 2,4,5 – T,

Substanca që pengojnë ndarjen e qelizave të barërave të egra: Chlorsulfuron (mund të përdoren në doza të vogla 10 – 100 gr/ha).

Duke konsideruar që duhet të ndërhyhet kryesisht në rresht, në një ha ullishte sipërfaqja që realisht duhet trajtuar është rreth 50 % e sipërfaqes totale.

Volumi i solucionit për t’u shpërndarë varet nga shpejtësia operative dhe kapaciteti përcjellës i pompës.

1. Shpejtësia e lëvizjes

- me pompa shpine është mesatarisht 2-3 km/orë (përshkon 100 m në 2-3 minuta)
- me traktor shpejtësia arrin 4-5 km/orë

2. Shpërndarësit e solucionit që duhen përdorur

Është e nevojshme të llogarisim sasinë e solucionit që hedhin shpërndarësit në këtë mënyrë:

$$Q = \frac{V \times L \times v}{600 \times N^\circ}$$

q- kapaciteti hedhës i shpërndarësit (stekës së pompës)

V- volumi/ha që duhet të shpërndajmë

L - gjërësia e rripit të tokës që do të trajtohet

600 - faktor fiks

N° - numri i shpërndarësve (stekave)

Shembull:

a. Për pompa shpine

$$q = \frac{400 \times 0.4 \times 2,5}{600 \times 1} = 0.66 \text{ lit/min}$$

b. Për pompa mekanike

$$q = \frac{400 \times 0.4 \times 5}{600 \times 1} = 1.33 \text{ lit/min}$$

Për llogaritjen e prurjes mund të konsultohemi me tabela të posaçme që përmbajnë elementët e mësipërm në shifra orientuese për shumicën e shpërndarësve në përdorim.

Duke konsideruar që presioni i këshillushëm i ushtruar është 1-2 bar për pompat e shpinës dhe 3-5 bar për pompat mekanike. Zgjidhen shpërndarës 02 me 2 bar dhe 025 me 5 bar presion.

Shpërndarësit më të përshtatshëm për trajtim me herbicid janë ata në trajtë freskoreje që dallohen nga ngjyra të ndryshme në bazë të prurjes.

Në rastin e mjeteve të pa pajisura me manometër bëhet një provë në bankë me ujë për të njohur prurjen e shpërndarësit. Në treg ka dhe mjete “me pikë të kalibruar”, që lejojnë shpërndarje soluzioni pa ujë, me mundësi të gjëra të rregullimit të saj.

Tabela. 1. Herbicide që mund të përdoren në ullishte:

Barëra konkurrues	Kriteret e trajtimit	Herbicidi	L. aktive %	Doza litër ose kg/ha
Graminace dhe dykotiledone	- trajtimi bëhet në rresht kur barërat konkurrues janë në fillim të zhvillimit	Glyphosinate	30.4	7.5 l/ha
	- trajtimi përsëritet në rast nevoje	Carfentrazone etil ¹	6.45	1 l/ha
	- të këshillushme janë ndërhyrjet në vjeshtë	Oxadioazon ²	34.1	2.5 l/ha
	- përdorimi bëhet i nevojshëm kur: - ka rrezik erozioni - kurora e ullirit është e ulët dhe nuk lejohet përdorimi i mjeteve mekanike	Oxifluorfen ³	22.9	1 l/ha

Trajtimi duhet të lokalizohet në rresht. Hapësira e trajtuar nuk duhet të kalojë 50 % të gjithë sipërfaqes.

1. Bëhet një trajtim: doza 0.3 l/ha
2. I përdorshëm vetëm 2 vitet e para
3. Të përdoret në doza të reduktuara (0.3 – 0.45 l/ 1 trajtim)

Të dhëna teknike:

Normalisht me një ndërhyrje pas vjeljes dhe një von në pranverë mbahet pastër rreshti për gjithë periudhën kritike. Në rast të kombinimit të trajtimeve me mbajtjen një kohë të tokës me mbulesë bimore rekomandohet reduktimi dozave.

Glyphosate zotëron një veprim sistemi dhe këshillohet të kombinohet me Oxifluorfen ose MCPA për të rritur efikasitetin kundër gjethe gjërave edhe pse të përdorura në doza minimale.

Veprimi shtohet më tej duke shtuar aktivues si Sulfat amoni (2kg/hl ujë) ose produkte me veprim të ngjashëm.

Këto përzierje shpërndahen mbi barërat konkurrues me zhvillim mesatar - të reduktuar, jo në kushte thatësire dhe duke evituar shplarjen deri në disa orë pas trajtimit. Me mjete të mbrojtura dhe duke bërë shumë kujdes për të mos prekur trungun, është e mundur të përdoren edhe në bimë të reja deri në tre vjet. Ndërhyrjet vjeshtore, pas vjeljes, rezultojnë shumë efikase edhe në doza minimale.

Me ndërhyrjet në pranverë - verë është e mundur të dëmtohen dhe thithakët. Për barëra konkurrues më pak të ndjeshme ndaj Glyphosate si: Drethëza, graminacet etj, këshillohet të ndërhyhet në mënyrë të lokalizuar me doza, më së shumti, të MCPA për të evituar shtrirjen e tyre.

Rekomandime:

- Të trajtojmë me herbicid vetëm në rresht duke përdorur vetëm një shpërndarës dhe duke ruajtur distancën nga bima.
- Nuk duhet të tejkalohen dozat e këshilluara, duke arritur në limitet e paraqitura në etiketën e produktit.
- Të ndalohen trajtimet me herbicid me fillimin e lulëzimit dhe të paktën 1 muaj para fillimit të vjeljes.

RREZIQET QË RRJEDHIN NGA PËRDORIMI I HERBICIDEVE:

Rreziku rrjedh nga toksiciteti i produktit, nga mënyra dhe koha e ekspozimit.

1. Rreziqet për operatorët:

- Mund të pësojë toksicitet akut: kur thith lëndë aktive të produktit në sasira të mëdha e cila mund të provokojë edhe vdekjen e tij dhe toksicitet kronik kur kjo lëndë thithet gradualisht nëpërmjet rrugëve të frymëmarrjes, të kontaktit etj.
- Puntori, para fillimit të punës, duhet të studiojë me kujdes masat mbrojtëse që duhet të marrë: përparëse, maska, syze, dorashka etj.
- Gjatë punës operatori nuk duhet të hajë, të pijë ose të pijë duhan.
- Mbas përfundimit të punës duhet të lahet dhe ndërrohet.
- Pompat duhet të jenë në kushte perfekte pune
- Duhet të evitohen humbjet e produktit gjatë shpërndarjes së tij
- Aplikimi duhet bërë në kohë pa erë, në temperatura të përshtatshme etj.
- Në rast helmimi duhet të shkojmë tek mjeku dhe t'i tregojmë etiketën e produktit të përdorur.

2. Rreziqet për kulturën:

- Herbicidet nuk duhet të hyjnë në kontakt me bimën e kultivuar sespe shkaktojnë toksicitet mbi të.
- Nëqoftëse herbicidi hyn në kontakt me frutin mund të kontaminojë nënproduktet e tij.
- Rreziqe më të mëdha paraqesin: Diflufenican, Oxifluorfan, Quizalofop-P, Terbutilazina, Diuron, MCPA dhe Simazina; rrezik më i madh për Diquat apo Glyphosate.

BIBLIOGRAFIA

L'USO DEGLI ERBICIDI

Gestione del suolo in olivicoltura A.Cimato, Elena Franchini

Tecniche di produzione in olivicoltura Consiglio oleicolo internazionale

L'ulivo e l'olio Renzo Angelini, Michele Pisante, Solange Ramazzotti, Fabio Stagnani, Pasquale Montemurro

Vlorë më: 10.11.2011